

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

|         |                                                                                                        |
|---------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| TITULLI | Ishte dënuar për vrasjen e bashkëshortes, 49-vjeçari i jep fund jetës në burgun e Reçit                |
| ADRESA  | https://piranjat.al/aktualitet/ishte-denuar-per-n-e-bashkeshortes-49-vjecari-i-jep-fund-jetes--i106209 |
| BURIMI  | piranjat.al                                                                                            |
| GJENDJA | online                                                                                                 |

## KOHA


|                       |                                                                                                                                                           |
|-----------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KAPUR NGA NE          | 26 shtator 2026, 16:01:41 UTC<br><i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>                            |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 26 shtator 2026, 15:58:00 UTC<br><i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i> |

## HASH-ET · SHA-256

|            |                                                                  |
|------------|------------------------------------------------------------------|
| PËRMBAJTJA | 03ad329caec9be6dfe0f7545a0123ce3ad204499dd8570c917a1f438c382b7f8 |
| TEKSTI     | 45ce5ccae5bda3aecdafdc27efe31db974ab1e15730d89539ce55a7efadb9721 |
| PAMJA      | 78cba2d969e1f95bb297248ee5f37169a7aa16c9bf197148c06e9fd8ad9ab3e3 |

## ZINXHIRI I PROVËS

|               |                                                                                                 |
|---------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KJO HYRJE     | 5c0bb16b1ec59cd5934430283f5b1dc6c4eec91441fabe37b94cc261153633d1                                |
| E MËPARSHMJA  | —                                                                                               |
| RRËNJA MERKLE | 0334a22cab892da6eda5613cc640e69aa8a23a21585bae5896651df887e79535                                |
| ANKORIMI      | submitted — dërguar, ende pa bllok<br><i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i> |



## SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/5c0bb16b1ec59cd5934430283f5b1dc6c4eec91441fabe37b94cc261153633d1

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px





- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

[SYRI LIVE](#)



Flash: **ne Elbasan, bllokohet** ■ Elbasan. Për shkak të ■ **Zbardhet ngjarja** ■ Ka përfunduar me të shtrëna ■ **Gramshit, plagosen** ■ automjete janë përplasur ■ **të ri të SHBA-ve në** ■ Shteteve të Bashkuara të Amerikës në ■ **motër që humbën** ■ motër e vëlla, të cilët ■ **rikthehe** ■ në

[AKTUALITET](#)

## Ishte dënuar për vrasjen e bashkëshortes, 49-vjeçari i jep fund jetës në burgun e Reçit

Piranjat Përditësimi i fundit 26 Shtator 2026, 17:58



Një i burgosur në burgun e Reçit i ka dhënë fund jetës. Shtetasi Agron Llapushi, 49 vjeç është gjetur i varur me litar në mjediset e dusheve në burgun e Reçit.

49-vjeçari nuk ka folur me askënd lidhur me këtë veprim duke zgjedhur që t'i japë fund jetës. Agron Llapushi i lindur në fshatin Holtas dhe banues në Çekin të Gramshit, në vitin 2015 vrau bashkëshorten e tij Alketa Llapushi.

Sapo u kthye nga emigrimi në Greqi, asokohe 39 vjeç Llapushi në një arë në Gramsh mbyti bashkëshorten me duar dhe litar duke e lënë të vdekur në vend.

Çifti në fjalë janë prindër të dy fëmijëve që sot janë 20 dhe 19 vjeç ndërsa asokohe ishin ende të vegjël.

Agron Llapushi nuk kishte takime me familjar apo të afërm. Ka patur vetëm një takim në vitin 2023, 8 vite pasi është dënuar dhe një tjetër në vitin 2025. Gjatë gjithë periudhës tjetër, askush nuk e ka takuar 49-vjeçarin.

Pas ngjarjes së rëndë, Agron Llapushi u dorëzua në polici dhe pranoi krimin e rëndë të kryer.

Prokuroria për Krime të Rënda asokohe kërkoi burg përjetë për shtetasin Agron Llapushi por Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda e dënoi me 24 vite e 4 muaj burgim për veprën penale "Vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare", parashikuar nga neni 79/c i Kodit Penal. Vendimi mori formë të prerë me datë 10.12.2015 ndërsa ishte arrestuar 8 muaj më parë, me datë 01.04.2015.

Rrëfimi i të dënuarit Agron Llapushi pas ngjarjes

Vetë i dënuari që i dha fund jetës, pranoi krimin dhe theksoi se ngjarja erdhi si pasojë e debateve për gjendjen e vështirë ekonomike.

"Jam martuar me Alketa Llapushin që nga viti 2001 dhe kemi dy fëmijë të moshës 10 dhe 9 vjeç.

Në lidhje me ngjarjen dua të deklaroj se kam vite që punoj si emigrant në Greqi në qytetin e Verias.

Para një viti unë kam pasur çrregullime mendore dhe kam kaluar në depresion, ku në disa raste me ka vajtur mendja të vrisja veten. Po kështu para një viti kam bërë një vizitë tek një psikolog në Elbasan me emrin Enrik.

Unë kam 4 ditë që kam ardhur nga Greqia dhe në fshatin ku unë banoj në Çekin jam në kushte të vështira ekonomike, ku unë jetoj bashkë me nusen time dhe dy fëmijët në një dhomë të vetme.

Sot unë kam shkuar në mëngjes për të punuar në një tokë larg shtëpisë në vendin e quajtur "Mhalla e Lepurit" dhe atje në punë e sipër jam konfliktuar me Alketën, dhe gjatë konfliktit unë e kam shtrënguar me duar në fyt derisa ajo ka humbur ndjenjat.

Pas kësaj kam shkuar në shtëpi dhe kam lajmëruar me telefon vëllain tim Alfreddin dhe me pas kam shkuar dhe jam dorëzuar në polici. Marrëdhëniet në përgjithësi me Alketën, i kam pasur të mira nuk kemi pasur probleme. As vetë nuk e di si ndodhi..."

## Artikuj te sugjeruar

AKTUALITET 26 Shtator 17:52

[Alketa Llapushi: Vrasja e bashkëshortes në burgun e Reçit](#)

## AKTUALITETET 26 Shtator 2017

Një aksident automobilistik është regjistruar ditën e sotme në autostradën Durrës-Tiranë, pranë Sukthit. Nga fotot ...

AKTUALITET 26 Shtator 17:47

### Artan Hoxha "plas bombën": 3 PC-ve te SHISH iu janë hequr hard-disqet. Bashkëpunëtorë të Hysenit fshinë provat

Gazetari Artan Hoxha ka ngritur pretendime të forta mbi lëvizjet e ish-drejtores së SHISH, Vlora Hysenit, para arrestimit të saj. Hoxha tha s...

AKTUALITET 26 Shtator 16:45

### Autobusi përfshihet nga flakët në hyrje të tunelit në Elbasan, bllokohet rruga

Një autobus është përfshirë nga flakët në hyrje të tunelit në Elbasan. Për shkak të incidentit, rruga &e...

AKTUALITET 26 Shtator 16:41

### Zjarr në katin e parë të një hoteli në Gjirokastrë

Një zjarr ka rënë në katin e parë të hotel "Garden", në lagjen "18 Shtatori" në Gjirokastrë...

AKTUALITET 26 Shtator 16:09

### Transportoni emigrantë të paligjshëm, dy makinat përplasen me patrullën e policisë, shpallen në kërkim drejtuesit

Dy persona janë shpallur në kërkim, ndërsa një tjetër është proceduar penalisht pas një operacioni gjatë tran...

AKTUALITET 26 Shtator 15:40

### Aksident në Gjirokastrë, makina përplas këmbësoren

Një 78-vjeçare është përplasur nga një automjet mesditën e sotme në Gjirokastrë, te zona e "Postbllokut&r...

AKTUALITET 26 Shtator 15:33

### Plumb në këmbë pas sherrit në lokal/ Zbardhet ngjarja në Tiranë, 54-vjeçari ende në kërkim

Një konflikt i nisur në një lokal në Tiranë ka përfunduar me të shtëna, plagosje dhe arrestimin e një 20-vje&cced...

AKTUALITET 26 Shtator 15:27

### Përplasen tre automjete në hyrje të Gramshit, plagosen tre persona

Një aksident rrugor ka ndodhur në hyrje të Gramshit, ku tre automjete janë përplasur me njëra-tjetrën. Si pasojë e ak...

AKTUALITET 26 Shtator 15:10

### Ra në korent teksa punonte në një varkë në Durrës, humb jetën 28-vjeçari nga Filipinet

Një 28-vjeçar me origjinë nga Filipinet ka humbur jetën në Durrës, pasi ra në kontakt me energjinë elektrike teksa p...

AKTUALITET 26 Shtator 14:27

### Presidenti Begaj pret letrat kredenciale të ambasadorit të ri të SHBA-ve në Tiranë, Eric Wendt

Presidenti i Republikës, Bajram Begaj, priti sot Ambasadorin e ri të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Shqipëri, Eric We...

## **ME TE VIZITUARAT**

SHOWBIZ 25 Shtator

### "Fjeta milioner dhe u zgjova i rrënuar", Robert...

Roberto Carlos ka rrëfyer një nga periudhat më të errëta të jetës së tij, duke zbuluar kalvarin me të cilin u p&eum...

AKTUALITET 26 Shtator

### E TRISHTË/ Këta janë Flori dhe Florida, vëlla e...

Personat që shihni në foto janë Flori dhe Florida Hoxha, motër e vëlla, të cilët humbën jetën tragjikisht pas shp...

AKTUALITET 25 Shtator

### Zbardhet lista/ 44 restorantet ku u tregtua dja...

Pas alarmit të dhënë për hyrjen në Shqipëri të një loti të kontaminuar djathi "Brie" nga Italia, zbardhet nga media...

INVESTIGIME 26 Shtator13:10

**Nga burgu në arrest shtëpie/ Eduard Limaj rikthehet në përndjekje të grave!**

Javën e shkuar ju folëm për dramën e një zonje 40-vjeçare, nënë e dy fëmijëve, e cila përndiqej nga 5...

**video**



**PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 2**






PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 2



Nga burgu në arrest shtëpie: Eduard Limaj rikthehet te përndjekja e grave!



**Haris Vongli: Dua të kthehem në Shqipëri për Davidin, tim bir.**



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.